



**KONTRATE PER THEMELIMIN E SHOQERISE
"FUTBOLL KLUB SUKTHI" S.H.A**

Sot, më datë 20.07.2009, para meje Noteres Gentiana Brati në zyrën time të noterisë, me adresë:
Rr: "At Gjergj Fishta", kulla nr. 10, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, u paraqit personalisht: aksioneret.

1. **Bashkia "SUKTH"** e përfaqësuar nga kryetari I Bashkise Z. YRJAN HASANI I dtl. 21.05.1968, lindur ne Kolonje dhe banues ne Sukth, identifikuar me ane Pashjaportes nr Z 2195326
2. **ALBERT MUHARREMI** I dtl. 27.11.1977, lindur ne Shijak Durres, identifikuar me ane te Pashaportes nr Z 1995036
3. **KLEODJAN LUKU I dtl., 16.11.1973**, lindur ne Shijak, Durres, dhe banues ne Itali, identifikuar me ane te Pashaportes nr Z 0089903
4. **VEIZ MUHARREMI I dtl. 20.09.1959**, lindur ne Lushnje dhe banues ne Sukth, identifikuar me ane te Pashaportes nr Z 0827987
5. **NAIM KALAÇI I dtl. 22.06.1965**, lindur ne Elbasan dhe banues ne Sukth, Identifikuar me ane te Pashaportes nr Z 0647613

Te cilet, në bazë të **LIGJIT Nr. 9901, datë 14.4.2008 "PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE"**, **KODI CIVIL NE R.SH, LIGJI "PER NOTERINE"**, dhe ne baze te Ligjit Nr 8650, date 28.07.2000 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr 8114, date 28.03.1996 "Per Sportin"

VENDOSËN:

1. Të krijojnë Shoqërinë me emërtimin **"FUTBOLL KLUB SUKTHI" S.H.A**

2. **Objekti** i veprimtarisë së Shoqërisë është:

- Krijimi I Skuadres se Futbollit te Paraterinjve, Skuadres se futbollit te te rinjve, Skuadres se Futbollit te te Rriturve.
- Organizimin e veprimtarive te ndryshme sportive, konkretisht te aktivitetit te futbollit ne Bashkine e Qytetit te Sukthit, sipas Sistemit Zinxhir, qe perfshin jo vetem ekipin e pare por edhe ekipin e paraterinjve, te rinjve dhe Ekipin e Futbollit te te Rriturve te Bashkise se Sukthit.
- Sigurimi I nje baze te rendesishme materiale per te realizuar paisjen e ketyre ekipeve me lojtare profesioniste dhe cilesore, duke realizuar edhe shit/blerjen e ketyre lojtareve, nga vende te ndryshme dhe nga ekipe futbollistike analoge, brenda dhe jashte Shqiperise.
- Kontraktimin per te drejten televizive me te gjithë personatë fizik dhe juridik, vendas apo edhe te huaj per transmetimin e ndeshjeve te futbollit te ekipit te futbollit me kete emer, si dhe te cdo aktiviteti tjetër sportiv qe do te kryeje shoqeria per arrijten e ketij qellimi.

(Handwritten signatures of the founders)

- Organizimin e aktiviteteve te ndryshme qe kane te bejne me marketingun e se drejtes radio televizive qe kane te bejne me fushen e reklamave te menaxhimit te reklamave, te mexhimit te lojtareve, Brenda dhe jashte vendit duke respektuar rregullat e percaktuara per kete qellim nga F.SH.F
- Krijimin e terreneve te ndryshme sportive me qellim ushtirim e aktiviteteve te ndryshme sportive per te gjithë ekipet qe do te krijohen prane ketij Sport Klubi.
- Menaxhimin e ketyre terreneve sportive sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.
- Menaxhimi, prodhimi dhe shitjen e materialeve te ndryshme sportive, per te arritur krijimin e te mirave materiale per funksionimin sa me dinjotoz te kesaj shoqerie. Eksportimin dhe importim te material te ndryshme sportive.
- Krijimi I te gjithë kushteve ekonomike, shoqerore, etj per acurine normale te veprimtarise se kesaj shoqerie.
- Mireorganizimi dhe mirefunksionimi I sportit te futbollit prane ketij Sport Klubi, duke krijuar kushte optimal pune dhe sportive per te gjithë ekipet e Sistemit Zinxhir..
- Krijimi, blerja, financimi, investimi, hyrja ne mardhenie te ndryshme me te tretet, kryerja e sipermarrjeve dhe projekteve, ofrimi i sherbime dhe asistences se te gjitha llojeve, personave fizike dhe juridike, perfshi sherbimet menaxhuese, keshilluese, planifikuese, financiare, turistike, teknike, administrative per arrijten e qellimit te kesaj shoqerie
- -Kryerja e sherbimeve per vete dhe per te trete, rikonstruksione per vete dhe te trete, prodhimi i materialeve te ndertimit dhe tregtimi i tyre me shumice dhe pakice.
- -Kerkimi, analizimi dhe perzgjedhja e personelit tekniko-administrativ. Punesimi i personelit te kualifikuar dhe venia ne dispozicion te kompanive nderkombetare. Konsulence juridike me kontraktoret e huaj ne trajtimin e ligjeve shqiptare apo ceshtje te ndryshme ligjore. Konsulence me kontraktoret e huaj ne kerkimin e personelit lokal tekniko-administrativ dhe venia ne dispozicionin te kontraktoreve. Konsulence me kontraktore te huaj vendas per tenderimin e projekteve me financim te huaj.
- -Shoqeria kryen cdo lloj veprimtarie te dobishme per arrijten e objektit te saj, duke perfshire edhe pjesmarrje ne kuota dhe aksione ne shoqeri dhe ndermarrje te tjera.

3. Shoqëria do të ketë **seline** ligjore Sukth

Shoqëria, përveç selisë zyrtare në Shqipëri, mund të hapë, brënda ose jashtë vendit filiale, agjenci apo zyra. Selia e shoqërisë mund të transferohet kudo në territorin e Republikës së Shqipërisë në bazë të një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të Jashtzakonshme të aksionerëve. Në rastin e një transferimi me vendim të Këshillit Mbikqyrës, ky i fundit është i autorizuar të bëjë ndryshimin e duhur në statut

4. Kapitali themeltar i Shoqërisë është 2 000 000. Ai është ndarë në- 2000 aksione. Vlera nominale e një aksioni është 1000 lekë.

5. **Aksioneret** e Shoqërisë jane

1. **Bashkia "SUKTH"** e përfaqësuar nga kryetari I Bashkise Z. YRJAN HASANI e cila zoteron 30% te aksioneve te kesaj shoqerie
2. **ALBERT MUHARREMI** I cili zoteron 67% te aksioneve te kesaj shoqerie
3. **KLEODJAN LUKU** I cili zoteron 1% te aksioneve te kesaj shoqerie

(Handwritten signatures of the founders)

4. **VEIZ MUHARREMI** i cili zoteron 1% te aksioneve te kesaj Shoqerie
5. **NAIM KALAÇI** i cili zoteron 1% te aksioneve te kesaj Shoqerie

Këshilli i parë Mbikqyrës përbëhet nga:

1. **ALBERT MUHARREMI**
2. **Bashkia "SUKTH"**
3. **KLEODJAN LUKU**

Keshilli mbikqyres zgjidhet per nje mandat tre vjecar.

7. **Kohëzgjatja** e Shoqërisë është e pacaktuar.

8. **Administratori i shoqerise** emërohet Z. **ALBERT MUHARREMI**

9. **Ekspert Kontabël** i Autorizuar emërohet Z. **ALMA HUSHO**

10. Ndërtimi, organizimi dhe funksionimi i Shoqërisë rregullohen sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar si edhe në bazë të Statutit dhe të këtij Akti Themelimi.

Shoqëria fillon veprimtarinë me nënshkrimin dhe miratimin e dokumenteve të saj themelues

ASIONERET

1. **Bashkia "SUKTH"** e përfaqësuar nga kryetari I Bashkise Z. YRJAN HASANI
2. **ALBERT MUHARREMI** *Albert Muharremi*
3. **KLEODJAN LUKU** *Kleodjan Luku*
4. **VEIZ MUHARREMI** *Veiz Muharremi*
5. **NAIM KALAÇI** *Naim Kalazhi*



**NOTERE
GENTIANA BRATI**



(Handwritten signature of the Notary)